



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Botimi 8

## **BULETINI**

### **I**

## **UDHËZIMEVE TEKNIKE NR. 8**

(Janar – Qershor 2021)



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. **HYRJE**.....

2. **UDHËZIME TEKNIKE**.....

2.1. *Sqaruese lidhur me trajtimin fiskal të produkteve falas*

2.2. *Sqaruese lidhur me lëshimin e faturës tatimore nga Përfaqësuesi tatimor sipas ligjit*

2.3 *Trajtimi fiskal në lidhje me TVSh-në, për mallrat që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike. (p. sh. ushqimi për të punësuarit e një resoranti)*

2.4 *Trajtimi i rasteve të individëve të cilët kanë plotësuar, dorëzuar dhe paguar detyrimet e rezultuara nga Deklarata Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), për vitet që sipas pretendimit të tyre nuk e kanë patur detyrim ligjor dorëzimin e kësaj deklarate.*

2.5 *Aplikimi për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve Ndërkombëtare për Eliminimin e Taksimit të Dyfishtë*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### I. HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve rregullohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tyre. Këto dispozita saktësojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Vlen të theksohet se, prioritet i administratës tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve si dhe respektimi korrekt dhe i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të marrëdhënies së vazhdueshme administratë tatimore – tatimpagues, si dhe e udhëhequr nga parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, publikon Buletinin Nr.4, në të cilin janë përfshirë sqaruese/orientuese dhe trajtime për raste specifike të adresuara në administratën tatimore nga tatimpagues të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky Buletin vjen si vazhdimësi e Buletineve të mëparshëm të publikuara në website-in e administratës tatimore, në të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale dhe në trajtim të dhjetëra shkresave dhe kërkesave të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë, ka përmbledhur raste specifike, të cilat mund të shërbejnë si referencë për tatimpagues të ndryshëm në trajtimin e një sërë problemesh që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor, me procedurat tatimore apo edhe me çështje dhe raste praktike.

Referuar sa më sipër, ky Buletin, është një përmbledhje e sqarimeve, opinioneve dhe udhëzimeve, që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve dhe përfshin periudhën nga 1 Janar 2019 deri më 30 Qershor 2019.

Ky Buletin në logjikën e buletineve të mëparshëm është i organizuar në 3 kapituj, të cilët respektivisht janë ndarë në kapitullin hyrës, në kapitullin II, në të cilin përfshihet një sqaruese/orientuese që u drejtohet Drejtorive Rajonale, me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me regjistrimin apo çregjistrimin nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së për OJF-të dhe unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e këtyre të fundit. Si dhe një sqaruese në nëndarjen e dytë për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambjentet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

aktiviteti tregtar edhe kapitulli III, i cili përmban një trajtim nga pikëpamja fiskale e huapërdorjes për sendet e luajtshme.

### 2. UDHËZIME TEKNIKE

#### 2.1. *Kërkesë për sqarim lidhur me trajtimin fiskal të produkteve falas*

Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” Neni 9 “Furnizimi i mallrave kundrejt pagesës”, përcakton: *“Furnizimi i mallit konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, nëse furnizuesi direkt apo indirekt merr apo ka të drejtë të marrë pagesë në para a në natyrë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër”*

Referuar dispozitës së sipërcituar, furnizimi i mallit konsiderohet kundrejt pagesës nëse personi tatimpagues, i cili furnizon mallrat apo shërbimet merr apo ka të drejtë të marrë pagesa, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.

Pra, pavarësisht se çmimi i mallit paguhet nga personi i furnizuar apo nga një person tjetër, furnizimi do të konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës. Nëse rezulton se, pagesën e keni marrë nga furnizuesi kryesor, pra kushti sipas nenit të sipërcituar është plotësuar si rrjedhojë. furnizimi që ju keni kryer është furnizim kundrejt pagesës dhe ky furnizim do të jetë me TVSH.

Sa më sipër, mallrat të cilat jepen falas, në bazë të një raporti kontraktor midis palëve, furnizimi do t'i nënshtrohet TVSH, duke qenë se marrëveshja midis palëve nuk ndikon në zbatimin e ligjeve në fushën fiskale.

Udhëzimi nr.6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 16 “Përcaktimi i dhuratave me vlerë të vogël dhe mostrave (kampionëve)”, përcakton se: *“Në pikën 3 dhe 4 të nenit 9 të ligjit nuk konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës rastet kur një person i tatueshëm përdor, shfrytëzon mallra të biznesit si dhurata me vlerë të vogël apo mostra (kampionë).*

*Për qëllime të aplikimit të dispozitës së parashikuar, mostër (kampion) konsiderohen ato objekte të lidhura drejtpërdrejtë me kryerjen e aktiviteteve të personave të tatueshëm, që i ofrohen konsumatorëve, klientëve të zakonshëm apo atyre potencial dhe nuk janë për qëllime shitje. Këto objekte nuk janë për qëllime shitje ose nuk shiten pasi kanë trajtën që pamundëson shitjen e tyre. Mallrat që jepen si mostra biznesi duhet të jenë të shenjëzuara si*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

*të tilla dhe duhet ta kenë trajtën ose paketimin ndryshe krahasuar me mallrat (objektet) të cilat kanë për qëllim shitjen”.*

Referuar udhëzimit të sipërcituar, nuk konsiderohen furnizime kundrejt pagesës ato mallra të biznesit të cilat i shfrytëzon si dhurata me vlerë të vogël, të cilat nuk kanë trajtën që duhet për të mundësuar shitjen e tyre. Pra, ligji ka përcaktuar se mostra (kampionët) janë objekte të cilat në krahsim me vlerën e mallit që përbëjnë objektin e veprimtarisë janë të një madhësie shumë herë më të vogël se madhësia e objekteve që shiten normalisht ose paketimi është ndryshe nga mallrat që janë objekt të veprimtarisë.

Pra, nëse një coca-cola është 33 cl, kampionët për t'u shitur duhet të jenë sasi më të vogël se 33 cl ose duhet që mbi këto objekte ose paketime të jetë shënuar se nuk janë për shitje (mostra).

Gjithashtu, sqarojmë se, shoqëria nuk mund të faturojë produktet që jepen falas me një çmim jo më të vogël se çmimi i blerjes, por faturimi duhet të përfshijë të gjithë elementët e përcaktuar në ligj.

Ku konkretisht Neni 39 “Vlera e tatueshme”, përcakton se: *“Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme:*

- a)tatimet, taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.*
- b)shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që furnizuesi ia ngarkon blerësit ose klientit.*
- c)për qëllime të shkronjës “b”, të kësaj pike, konsiderohen gjithashtu si shpenzime dytësore ato të parashikuara në marrëveshje të veçanta”.*

Përsa i përket uljeve të çmimeve të aplikuara nga shoqëria juaj për objektet e veprimtarisë, ligji ka përcaktuar se bëhen pjesë e vlerës së tatueshme pagesat që i jepen ose përfitohen prej rishitësit, në formën e uljes së çmimit ose pagesa periodike.

Konkretisht, pika 3, neni 30 “Elementët që përfshihen në vlerën e tatueshme” është përcaktuar se: *“Furnizime shërbimi të ndryshme, të kryera në funksion të realizimit të shitjeve ose blerjeve që kryen pas furnizimit Bëhen pjesë e vlerës së tatueshme të një furnizimi dhe janë të tatueshme me TVSH, pagesat që i jepen ose përfitohen prej ri-shitësit, në formën e uljes së çmimit, apo që i derdhen periodikisht atij në funksion të shitjeve ose pjesë-pjesëgjatë zbatimit nga ana e ri-shitësit të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e shitjes ose edhe në formën e klauzolës së garancisë”.*

Shembull 1: *Një shoqëri pijesh i jep ekskluzivitetin një shoqërie të tregtojë produktet e markës së saj dhe për këtë i jep një pagesë për realizimin e shitjeve të produktit mbi*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

*një sasi ose vlerë të caktuar. Shuma e përfituar nga rishitësi i produkteve është e tatueshme me TVSH, edhe nëse nuk përfitohet si pagesë, por në formën e zbritjes për furnizimin e radhës të kryer.*

Pra, dhe në rastet kur përfitoni pagesa apo ulje çmimi apo shërbime të cilat kryhen në kuadër të realizimit të shitjeve mbi një sasi të caktuar apo sipas kontratës së lidhur me furnizuesin, këto përfitime apo shërbime janë të tatueshme me TVSH.

Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, trajtimi fiskal i produkteve falas për qëllime të TVSH dhe tatimin mbi fitimin, do të jetë i tillë që, në vlerën e tatueshme do të përfshihen të gjitha elementët e përcaktuar në dispozitat e ligjit që përbëjnë vlerën e tatueshme.

### **2.2. Lëshimi i faturës tatimore nga përfaqësuesi tatimor**

Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” Neni 87 “Përfaqësuesi tatimor” përcaktohet se: *“Në rastet që i referohen pikës 1, të nenit 86, të këtij ligji, kur personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja, në zbatim të këtij neni, ky person duhet të caktojë një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë si person përgjegjës për pagesën e TVSH-së, përveç kur personi, të cilit i janë furnizuar mallrat ose shërbimet, është një person i tatueshëm, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe i nënshtrohet pikës 2, të nenit 86, të këtij ligji”.*

Referuar nenit të sipërcituar, roli i përfaqësuesit tatimor është të kyejë pagesat e Tvsh-së në emër të përfaqësuarit person jo-rezident. Përfaqësuesi përfaqëson të përfaqësuarin jo rezident për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin në Republikën e Shqipërisë.

Përsa i përket faturës tatimore për furnizimet e vazhdueshme, Ligji.Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 99 “Momenti i lëshimit të faturës” pika 5, përcakton se: *“Fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme, të realizuara midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj, në të cilin furnizimet janë kryer.”*

Ligji ka përcaktuar lëshimin e faturës periodike, kur furnizimi kryhet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj.

Pra, fatura lëshohet në mënyrë periodike kur midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij kryhen furnizime të vazhdueshme, e cila mund të evidentohet dhe nëpërmjet kontratës që palët kanë lidhur ndërmjet tyre. Referuar sa më sipër, vazhdueshmëria e furnizimit del jo nga numri i klientëve që ka tatimpaguesi, por nga numri i furnizimeve me të njëjtin klient.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Gjithashtu, ligji në nenin e sipërcituar, ka përcaktuar se fatura lëshohet në mënyrë periodike midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij. Pra, personi i tatueshëm referohet personit të tatueshëm të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe jo përfaqësuesit tatimor.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, të gjithë tatmpaguesit do të duhet të angazhohen për respektimin e dispozitave të këtij ligji, për lëshimin e faturës së fiskalizuar.

Ligji Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, Neni 8 “Momenti i lëshimit të faturës” pika 6, përcaktohet se:

*“Për furnizime të shërbimeve sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të tilla si shërbimet e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike, por jo vetëm, për persona të patatueshëm, që kanë adresën e tyre të përhershme ose banojnë në Republikën e Shqipërisë, furnizuesi i huaj nëpërmjet përfaqësuesit të tij tatimor në Republikën e Shqipërisë lëshon fatura për furnizimet e shërbimeve të kryera për çdo blerës, person të patatueshëm dhe zbaton procedurën e fiskalizimit në përputhje me Ligjin në momentin e furnizimit. Përfaqësuesi tatimor është personalisht përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet për të cilat detyrohet personi i përfaqësuar, përfshirë detyrimin për të lëshuar faturat për çdo blerës sipas procedurës së fiskalizimit”.*

Sa më sipër, ligji në rastet e përcaktuara në nenin 29 dhe 30 të lligjit për Tatimin mbi vlerën e shtuar, fatura e lëshuar nga përfaqësuesi tatimor do të jetë për çdo blerës dhe momenti i lëshimit të faturës është koha kur kryhet furnizimi.

Pra, në rastet kur fatura lëshohet nëpërmjet përfaqësuesit tatimor, për shërbimet që janë të parashikuara nga neni 29 dhe 30 i Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, fatura elektronike do të lëshohet në momentin e furnizimit të shërbimit.

Sa më sipër dhe në lidhje me pyetjen tuaj, ju bëjmë me dije se, fatura e fiskalizuar duhet të lëshohet në momentin e furnizimit për çdo shërbim të kryer nga jo rezidenti nëpërmjet përfaqësuesit tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe, nuk mund të jetë një e vetme për të gjitha furnizimet e kryera blerësve të ndryshëm apo të njëjtë.

**2.3 Trajtimi fiskal në lidhje me TVSh-në, për mallrat që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike.(psh ushqimi për të punësuarit e një resoranti)**



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Çdo person i tatueshëm lidhur me mënyrën e zbatimit të TVSH-së për furnizimet që kryen në kuadër të aktivitetit të tij, duhet të ketë parasysh dispozitat e ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1. Kur një person i tatueshëm merr mallra që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike. (psh ushqimi për të punësuarit e një resoranti) .

Trajtohen gjithashtu si furnizime malli kundrejt pagesës rastet kur, një person i tatueshëm merr mallra që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike, në qoftë se ka zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-në në blerje të këtij malli apo elementeve që përbëjnë mallin.

Furnizimi kundrejt pagesës i shërbimeve është veprimi me anë të të cilit një person merr një furnizim shërbimi të tatueshëm nga mallrat, elementet apo mjetet që i përkasin pasurisë së ndërmarrjes.

Vendimi Nr 68 datë 7.2.2018 “ Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore” ka përcaktuar se, punëdhënësit, të cilët, për arsye të kushteve apo të organizimit të punës, nuk mund të sigurojnë lokal për ngrënie, me kushte higjienike të pranueshme (sipas lejes së punës, dhënë nga Inspektorati Shtetëror i Punës), duhet t’i shpërblejnë punëmarrësit për ushqimin që konsumohet gjatë pushimit nëndërmarrje.

Vlera, mënyrat dhe kriteret e dhënies së pagës nënatyrë do të jenë deri në masën 300 (treqind) lekë për një vakt dhe deri në masën 500 (pesëqind) lekë, kur trajtohet me më shumë se një vakt për ditë pune. Personi i tatueshëm është i detyruar të lëshojë faturë me TVSH për veten e tij (vetëfurnizimi) për çdo mall apo shërbim të ofruar punonjësve (ushqimi) dhe momenti i lëshimit të faturës do të jetë momenti kur shërbimi apo malli (ushqimi) i ofrohet stafit të tij për çdo vakt.

Shpërblimi në formën e pagës në natyrë mund të jepet në trajtim ushqimor, kupon dhe mall. Në raste të veçanta, kur nuk ekzistojnë mundësitë për dhënie të shpërblimit në asnjë nga këto forma, punonjësit i jepet shpërblimi në para dhe ky shpërblim, për efekte fiskale, trajtohet si paga.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

***2.4 Trajtimi i rasteve të individëve të cilët kanë plotësuar, dorëzuar dhe paguar detyrimet e rezultuara nga Deklarata Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), për vitet që sipas pretendimit të tyre nuk e kanë patur detyrim ligjor dorëzimin e kësaj deklarate.***

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenin 13 “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave” pika 1 përcaktohet se, tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

Ndërsa në pikën 4 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se, përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë. Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.

Ligji i sipërcituar përcakton se kanë detyrimin për të plotësuar dhe dorëzuar në administratën tatimore individët të cilët plotësojnë kushtet e sipërcituara, por nuk përjashtohen nga dorëzimi i kësaj deklarate kategorinë e individëve rezidentë apo jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, të cilët pavarësisht se nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në dispozitat ligjore, krijojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për periudhën/ periudhat e kërkuara prej tyre.

Theksojmë se, deklarata individuale e të ardhurave krijohet nga vetë individi deklarues dhe ai (individi) është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet për individët e punësuar në më shumë se një punëdhënës e ka zanafillën që nga viti 2016 (DIVA e dorëzuar në administratën tatimore deri 30 prill 2017).

Administrata tatimore ka krijuar mundësinë dhe lehtësinë që individët të cilët janë të detyruar apo kërkojnë të plotësojnë dhe dorëzojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), të kenë të paraplotësuar: rubrikën 3 “Të ardhurat bruto nga pagat dhe shpërblimet”, rubrikën 4 “Tatimin e llogaritur” dhe rubrikën 22 “Tatimi i paguar”, me qëllim plotësimin e saktë të rubrikave përkatëse.

**Për sa më sipër sqaruam, të gjithë individët të cilët kanë krijuar, plotësuar, dorëzuar dhe paguar detyrimin e rezultuar, kanë zbatuar nën përgjegjësinë e tyre dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi.**



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Informojmë se, Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA) krijohet për periudhën përkatëse, plotësohet dhe dorëzohet nga vetë individi deklarues.

Administrata tatimore identifikon vetëm ata individë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligj, të cilët njoftohen nga administrata në kohë për detyrimin që kanë.

Për sa ju trajtoni në shkresat tuaja të sipërcituara, të gjithë individët të cilët kanë plotësuar, dorëzuar dhe paguar detyrimin e tatimit mbi të ardhurat personale për vitet përpara vitit 2020 dhe kanë pretendime që nuk duhet të ishin subjekt i plotësimit të kësaj deklarate, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Apelitit Tatimor në Ministrinë e Financave.

Krijimi, plotësimi i saktë i të gjitha të rubrikave dhe dorëzimi i Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave është përgjegjësi e vetë individit deklarues dhe në zbatim të neneve 13 deri 13/10 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në rast se individi krijon DIVA për një periudhë X, ai duhet të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi.

Për rastet, kur individët të cilët nuk janë të qartë për plotësimin e Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave, në çdo kohë mund ti drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorisë Teknike dhe ligjore, Sektorit të Taksave Direkte.

### **2.5 Aplikimi për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve Ndërkombëtare për Eliminimin e Taksimit të Dyfishtë**

Tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike, të cilët duhet të aplikojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve Ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm me qëlim marrjen në shqyrtim:

- I. Procedurat për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare janë përcaktuar në Udhëzimin Nr.6, datë 10.02.2004 "Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal".

Në zbatim të këtij udhëzimi, subjektet tatimpagues, rezidentë në RSH duhet të aplikojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shmangien e tatimit të dyfishtë, duke depozituar dokumentacionin, si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim në lidhje me arsyet e aplikimit, si dhe informacion të plotë dhe shterues për:**
  - a) Llojin e shërbimeve si dhe mënyrën e ofrimit të tyre me/pa prezencë fizike të personelit teknik të huaj në RSH;
  - b) Informacion për kohëqëndrimin e personelit teknik të huaj në RSH, duke përfshirë edhe informacionin për të dhënat indentifikuese të secilit prej tyre (emër, mbiemër, ID).



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

2. *Formularin origjinal të marrëveshjes tatimore*, duke zbatuar kërkesat ligjore, si më poshtë:

- a) Plotësimin e saktë të të gjitha rubrikave të formularit sipas kërkesave për informacion që kërkon secila prej tyre.
- b) Nënshkrimin dhe vulosjen si nga shoqëria përfituese e të ardhurave, ashtu dhe nga autoriteti i huaj tatimor.

*\*Në lidhje me kërkesat sipas gërmave a); b) kërkohet që informacioni si dhe të gjithë elementet e formularit, të jenë të plotë, të qartë, origjinal (nënshkrimi dhe vula), pasi janë objekt verifikimi me autoritetin e huaj tatimor.*

- c) Çertifikatën origjinale të Rezidencës Tatimore të shoqërisë përfituese të të ardhurave, e vlefshme për vitin/vitet kur janë përfituar të ardhurat, objekt aplikimi i marrëveshjes.

*\* Çertifikata e Rezidencës Tatimore, sipas gërmës c) kërkohet në rastet kur Formularit të Aplikimit i mungojnë kërkesat e pikës 2/b (nënshkrimi dhe vula e autoritetit të huaj tatimor.*

3. Kontratën dhe/ose kontratat e lidhura me shoqërinë e huaj (*ofruese e shërbimit*), të njësuar me origjinalin dhe/ose origjinalet si dhe të përkthyer zyrarisht në gjuhën shqipe;
4. Kopje të faturave të lëshuara nga shoqëria e huaj, pagesat lidhur me to si dhe çdo dokument që vërteton dhe/ose provon kryerjen e shërbimit, kohëpërdorimin, respektimin e kërkesave të ligjit për transferimin e çmimit, përfshi por pa u kufizuar në urdhëra blerje, çdoganime, formulari i aplikimit për transferimin e çmimit, urdhëra marrje në dorëzim, etj.
5. Aplikimi për shmangien e Tatimit në Burim ndaj personave jorezidentë, në lidhje me shërbime që ata kryejnë në kuadrin e veprimtarisë së tyre biznesore për persona rezidentë shqiptarë, vetëm kur parashikohet në dispozitat e marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka lidhur me vendin, rezident i së cilës është përfituesi i të ardhurave, bëhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda afatit 2-vjeçar nga data e pagesës së faturës.

## II. Individët të cilët kërkojnë pajisje me Çertifikatë Residence Tatimore duhet të depozitojnë:

1. Kërkesë me shkrim në të cilën të përcaktohet shteti dhe viti fiskal për të cilën aplikojnë, si dhe informacion i plotë në lidhje me arsyet e kërkesës për pajisje me Çertifikatë Residence Tatimore.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

2. Vertetim origjinal lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit në të cilin jepen hyrje-daljet në Republikën e Shqipërisë, adresa e banimit, si dhe dokumenti/dokumentat indentifikues të përdorur nga individi aplikues. *(kjo e fundit i referohet rasteve për individët që kanë më shumë se një pasaportë).*
3. Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat personale të përfituara dhe deklaruara brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Për të ardhurat e përfituara brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë ti bashkëlidhet kërkesës dokumentat justifikues, si kontrata e shërbimit apo/dhe punësimit, dokument dhe/ose formularë zyrtarë që vërtetojnë përfitimin e të ardhurave, deklarin dhe tatimin e paguar. (dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer dhe legalizuar nga zyrë noteriale).
4. Kontrata e pronësisë së banesës ku banon apo kontrata e qerasë sipas rastit. (kopje kontrate origjinale dhe/ose e njësuar me origjinalin).

Kopje të dokumentit të indentifikimit, pasaportë ose kartë indentiteti, brenda afateve ligjore për sa i takon vlefshmërisë.